HARRIMI I FALJES SË NAMAZIT NË GJENDJE VENDËSIE DHE RIKUJTIMI I TIJ GJATË UDHËTIMIT

Nëse vendësi niset për udhëtim, dhe më pas gjatë udhëtimit i kujtohet një namaz katër-rekatesh që e ka harruar ta falë gjatë kohës kur ishte vendës – edhe pse aktualisht është udhëtar – ai duhet ta falë atë namaz me katër rekate të plota.

Konsensusi i dijetarëve rreth kësaj çështjeje

Imam Ahmedi, rahimehullah, ka thënë:

"Nëse vendësi niset për udhëtim, dhe më pas gjatë udhëtimit i kujtohet një namaz katër-rekatesh që e ka harruar ta falë gjatë kohës kur ishte vendës – edhe pse aktualisht është udhëtar – ai duhet ta falë atë namaz me katër rekate të plota. Ky është mendimi i të gjithë dijetarëve."[1]

Ky konsensus është transmetuar edhe nga:

1. Ibn Mundhiri, rahimehullah, i cili ka thënë:

"Të gjithë dijetarët kanë rënë në ujdi, dhe nuk di që në mesin e tyre ka divergjencë, se personi që, gjatë kohës sa ka qenë vendës, e ka harruar një namaz, e më pas niset për udhëtim, dhe gjatë udhëtimit i kujtohet namazi i harruar,

---

[1] **Shiko El-Mugni, (3/141); Sherh ez-Zerkeshi, (2/155); El-Mubdi', (2/110); El-Insaf, (5/55).**

ai duhet ta falë atë namaz sipas dispozitës së vendësit – edhe pse aktualisht është udhëtar – dhe se ndryshe nuk mund ta kompensojë këtë. Ndërkaq, Hasan el-Basriu ka një mendim tjetër në lidhje me këtë çështje."[2]

Sa i përket mendimit të Hasan el-Basriut, rahimehullah – se në këtë rast namazi duhet falur sipas dispozitës së udhëtarit – Ibn Mundhiri ka komentuar: *"Ky mendim nuk merret aspak në konsideratë dhe nuk dihet që ndonjë tjetër të ketë shprehur një qëndrim të ngjashëm."*[3]

---

[2] **Shiko El-Evsat, (4/368); El-Ixhma', (fq. 48).**

[3] **Shiko El-Evsat, (4/369).**

2. Muhamed el-Xhevheri, rahimehullah, i cili ka thënë:

"Të gjithë dijetarët kanë rënë në ujdi se personi, të cilit gjatë udhëtimit i kujtohet një namaz që e ka harruar ta falë gjatë kohës sa ka qenë vendës, ai duhet ta falë atë namaz sipas dispozitës së vendësit. Ndërkaq, Ubejdullah bin el-Hasan el-Anberi ka një mendim tjetër në lidhje me këtë çështje."[4]

3. Ibn Kudame, rahimehullah, e ka transmetuar konsensusin e dijetarëve, duke rënë dakord me të.[5]

4. Ibn Katani, rahimehullah.[6]

5. Zerkeshiu, rahimehullah, e ka transmetuar konsensusin e dijetarëve, duke rënë dakord me të.[7]

6. Autori i librit El-Mubdi', rahimehullah, e ka transmetuar konsensusin e dijetarëve, duke rënë dakord me të.[8]

---

[4] **Shiko Nevadir el-Fukaha', (fq. 64). Ubejdullah: Ebu el-Hurr bin el-Hasan el-Anberi, gjykatës në Basra, vdiq në vitin 168 të hixhretit. Shiko Tarih Bagdad, (10/306).**

[5] **Shiko El-Mugni, (3/142).**

[6] **Shiko El-Ikna', (1/168). Ibn Katani, po aty, e ka cekur deklaratën e Ibn Mundhirit në lidhje me konsensusin e dijetarëve, duke rënë dakord me të.**

[7] **Shiko Sherh ez-Zerkeshi, (2/155).**

[8] **Shiko El-Mubdi', (2/110).**

Argumenti në të cilin bazohet konsensusi dhe mënyra e argumentimit

Transmetohet se i Dërguari i Allahut (ﷺ) ka thënë:

"Kush harron ta falë namazin, le ta falë sapo t'i kujtohet. Nuk ka mënyrë tjetër për ta kompensuar atë namaz, përveçse në këtë formë."[9]

Në çështjen që po trajtojmë, personi ka harruar një namaz që ishte i obliguar ta falte me katër rekate gjatë kohës kur ishte vendës. Më pas, kur gjatë udhëtimit i kujtohet ky namaz, ai duhet ta falë pikërisht me të njëjtin numër rekatesh, ashtu siç i ishte bërë obligim në origjinë.[10]

---

[9] **Shënon Buhariu në Sahih, "Kapitulli i kohëve të namazit", nënkapitulli "Kush harron ta falë namazin, le ta falë sapo t'i kujtohet", (597); Muslimi në Sahih, "Kapitulli i xhamive", nënkapitulli "Kompensimi i namazeve të humbura", (684).**

[10] **Shiko El-Ishraf, e Kadiut Abdul-Vehhab, (1/310).**

Divergjenca e mëvonshme lidhur me këtë çështje

Mendimi i parë: Personi duhet ta falë namazin me katër rekate të plota dhe nuk lejohet ta shkurtojë në më pak se kaq. Ky është mendimi i shkollës juridike hanefite[11], malikite[12], shafi'ite[13] dhe hanbelite[14].

Mendimi i dytë: Lejohet që personi ta shkurtojë namazin në dy rekate. Transmetohet se në këtë mendim kanë anuar Hasan el-Basriu[15], Ubejdullah el-Anberi[16], Muzeniu[17] dhe Ibn Hazmi; madje, ky i fundit e ka konsideruar obligim që namazi të shkurtohet në dy rekate[18].

---

[11] Shiko Muhtesar el-Kuduri, (fq. 100); El-Hidajeh, (1/81).

[12] Shiko El-Mudevveneh, (1/119); El-Ishraf, (1/310). Disa dijetarë të shkollës juridike malikite e kanë kushtëzuar këtë në rastin kur namazi del nga koha e vet.

[13] Shiko El-Havi, (2/379); El-Mexhmu', (4/172).

[14] Shiko El-Mustev'ib, (2/395); El-Mugni, (3/141); Sherh ez-Zerkeshi, (2/155).

[15] Shiko El-Evsat, (4/369).

[16] Shiko Nevadir el-Fukaha', (fq. 65).

[17] Shiko El-Mexhmu', (4/172). Ndërsa në Muhtesar el-Muzeni, (fq. 40) shënohet se, në këtë rast, ai duhet ta falë namazin me katër rekate të plota.

[18] Shiko El-Muhal-la, (5/23).

Argumentimi i të dy palëve

Më herët u tregua argumenti në të cilin bazohet konsensusi, si edhe mënyra e argumentimit. Dijetarët që kanë mbështetur mendimin e parë janë bazuar si në këtë argument, ashtu edhe në vetë konsensusin e transmetuar. Për më tepër, nuk dihet që më herët të ketë ekzistuar një mendim i kundërt për këtë çështje; një mendim i tillë është shfaqur vetëm më vonë, pas konsensusit.

Dijetarët që kanë mbështetur mendimin e dytë janë bazuar në faktin se, nëse një person ka harruar ta falë një namaz gjatë kohës kur ka qenë vendës, dhe më pas gjatë udhëtimit i kujtohet, atëherë ai obligohet ta falë menjëherë në momentin kur i kujtohet. Për udhëtarin, obligim është ta falë namazin duke e shkurtuar në dy rekate, e jo ta falë atë me katër rekate të plota, sepse namazi që falet gjatë udhëtimit merr dispozitën e udhëtimit[19].

---

[19] **Shiko El-Muhal-la, (5/24).**

Konkluzioni

Si përfundim, mund të thuhet se konsensusi i transmetuar për këtë çështje mbetet i saktë. Nga Hasan el-Basriu është transmetuar gjithashtu një variant tjetër, i cili përputhet me këtë konsensus[20]. Ky është konsensusi që kanë transmetuar Imam Ahmedi dhe Ibn Mundhiri, të cilin e kanë mbështetur edhe dijetarët e tjerë pas tyre, dhe që ka ekzistuar që para shfaqjes së mendimit tjetër. Allahu e di më së miri.

---

[20] **Shënon Abdurrezaku në Musanef, (4389), me zinxhir deri te Hasan el-Basriu, se ka thënë:** ***"Kush harron ta falë një namaz gjatë kohës kur është vendës dhe vazhdon ta harrojë deri sa të udhëtojë, e më pas gjatë udhëtimit i kujtohet namazi i harruar, ai duhet ta falë me katër rekate të plota. Po ashtu, kush harron ta falë një namaz gjatë kohës kur është udhëtar dhe vazhdon ta harrojë deri sa të kthehet në vendin e tij, e më pas kur të kthehet i kujtohet namazi i harruar, edhe në këtë rast duhet ta falë me katër rekate të plota."***

Fragment nga libri:

Konsensuset fikhore të transmetuara nga Imam Ahmed bin Hanbeli – Përmbledhje dhe Studime, fq. 101–103.

Autori:

Dr. Muhamed bin Fehd bin Abdul-Aziz el-Furejh

Përktheu nga arabishtja:

Abdullah Avdyli

Xhumada el-Evvel 1447 / Nëntor 2025